



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR**

Nr. 4478 Prot

Peshkopi, më 06.11.2025

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr. 78

Datë: 03.11.2025 si dhe projekt-vendimin nr.16 Datë 28.10.2025

“Për Përdorimin e Fondit të akorduar nga Emergjencat Civile, për shpenzimin “Blerje karburant ”

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak



Kapji
06.11.2025
[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

4478/11/11/25

Nr.1015/1 prot.

Peshkopi, më 10.11.2025

Lënda: Kthim vendimi për rishqyrtim.

Bashkisë

DIBËR

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107 datë 27.10.2016, "Për Prefektin e Qarkut", I ndryshuar, pasi verifikoi ligjshmërinë e vendimit të Këshillit të Bashkisë Dibër nr.78 (shtatëdhjetetë) datë 03.11.2025, për shpenzime blerje karburanti për mbështetje të ndërhyrjes në ifrastruktur kritike, nga dëmtime nga faktorët natyror apo njerëzor, **konstatova se :**

Në zbatim të ligjit nr.45 datë 18.07.2019, "Për Mbrojtjen Civile", neni 28, shkronja l, neni 30, shkronja f, neni 43, pika 1, pika 2, shkronja a,b, neni 46, pika 2, shkronja a,b,c, të VKM nr.329 datë 16.05.2012, sipas kreu III, pika 1, shkronja e, pika 2, shkronjah h, të VKM nr.414 datë 08.07.2021, pika 3.1, shkronja b, si dhe vendimi 414/2021 i ndryshuar me vendimi nr.290/2023, shkronja ë, ku për rrjedhoj :

-Fondet për Emergjencat Civile, përdoren për riaftësimin të infrastrukturës kritike në territorin e qeverisjes vendore si ura, prita malore, rrugë, diga, argjinatura dhe impianteve të trajtimit për ujë e pijshëm apo të ndotur, mure mbajtës, karburante, shoqëruar me dokumentacion për ndërhyrje në infrastruktur të përcaktur, por jo për shpenzime pa u prekur nga fenomeni natyror.

Për këto arsye vendimi nr.78 (shtatëdhjetetë) datë 03.11.2025, kthehet për rishqyrtim duke kërkuar reflektimin e organit vendor në kushtet e respektimit të legjislacionit aktual në fuqi që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën e së drejtës.

Duke ju falenderuar për mirkuptimin.

PREFEKTI
Nexhbedin SHEHU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 78 Datë 03 /11 /2025

“Për Përdorimin e Fondit të akorduar nga Emergjencat Civile, për shpenzimin “Blerje karburant ”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar udhezimit nr.2 , date 24.01.2025 “Per zbatimin e buxhetit te vitit 2025” , VKM 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” dhe VKM nr 414 date 08/07/2021 “Per miratimin e kriterëve dhe procedurave te ndarjes dhe perdorimit te fondit te kushtezuar te buxhetit te shtetit per mbrojtjen civile” pika3.1 germa b,c,gj, Këshilli Bashkiak Diber në mbledhjen e datës **03.11.2025** me 18 vota pro 0 kundër 1 abstenim :

VENDOSI:

1. Nga fondi i akorduar nga Emergjencat Civile të përdoret për blerje karburant me vlerë financimi 1,200,000 (Njemilion e dyqind mije) lekë:
2. Te përdoret fondi emergjencave civile **10910** në vlerën **1,200,000** (Njemilion e dyqind mije) lekë. Përdorimi i shumës perkatese do te behet ne artikullin 604 programi 10910 e miratuar me shkresen nr.864/1 prot date 27.02.2025 te Ministrise Financave.
3. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e PPECK, Sektori i Prokurimeve Publike dhe Drejtoria Ekonomike (Sektori i Financës) pranë Bashkisë Diber.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Diber.
5. Vendimi u shpall më datë **03.11.2025**.

Kryetar i Këshillit Bashkiak



**BASHKIA DIBËR
DREJTORIA EKONOMIKE
PROJEKT-VENDIM**

Nr. 16 Datë 28/10/2025

“Për Përdorimin e Fondit të akorduar nga Emergjencat Civile, për shpenzimin “Blerje karburant”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar udhezimit nr.2, datë 24.01.2025 “Per zbatimin e buxhetit te vitit 2025”, VKM 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” dhe VKM nr 414 date 08/07/2021 “Per miratimin e kriterëve dhe procedurave te ndarjes dhe perdorimit te fondit te kushtezuar te buxhetit te shtetit per mbrojtjen civile” pika3.1 germa b,c,gj kërkojmë që fondi i akorduar nga Emergjencat Civile të përdoret si më poshtë:

Kërkojmë:

1. Nga fondi i akorduar nga Emergjencat Civile të përdoret për blerje karburant me vlerë financimi 1,200,000 (Njemilion e dyqind mije) lekë;
2. Te përdoret fondi emergjencave civile **10910** në vlerën **1,200,000** (Njemilion e dyqind mije) lekë. Përdorimi i shumës perkatese do te behet ne artikullin 604 programi 10910 e miratuar me shkresen nr.864/1 prot date 27.02.2025 te Ministrise Financave.
3. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e PPECK, Sektori i Prokurimeve Publike dhe Drejtoria Ekonomike (Sektori i Financës) pranë Bashkisë Dibër.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak Dibër dhe shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

PËR BASHKINË DIBËR:

Drejtor Juridik
Ismet Saraçi

Drejtor Ekonomik
Çeljeta Zuna

Në mungesë dhe me porosi

Zv. Kryetar
Lorenc Cibaku

Drejtor i PPECK
Sajmir Shehu

KRYETARI I BASHKISË
Rahim Spahiu



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DIBËR
DREJTORIA PPECK**

RELACION

Me miratimin e ligjit 45/2019, mbrojtja civile është kthyer në një prioritet për të gjithë organet e administratës publike. Një faktor i rëndësishëm në mbrojtjen civile janë organet e vetëqeverisjes vendore, si baza e konstatimit të situatave nevojave të komunitetit dhe si organe në paravijën e reagimit të shpejtë ndaj tyre, në rastin e një emergjente.

Sipas vendimit nr. 414, datë 8.7.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile", bashkitë mund të mbulojnë me fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile vetëm zërat e shpenzimit 604 (kompensim qytetarësh) dhe 602 (mallra dhe shërbime), duke kufizuar në këtë mënyrë hapësirën e vendimmarrjes të bashkive, në kuadër të reduktimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjes civile, si edhe të forcimit të kapaciteteve të tyre për përballimin e situatave emergjente të krijuara si pasojë e një fatkeqësie.

Organet e vetëqeverisjes vendore janë baza e konstatimit të nevojave të komunitetit dhe, si të tilla, duhet të jenë në gjendje të përdorin me sa më shumë efektivitet fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile në funksion të nevojave specifike të territorit të tyre, bazuar në këtë aspekt lind nevoja e planifikimit të këtij fondi në rast nevojë të sektorit për përballimin e situatës të paparashikueshme për parandalim të përmytjeve të tokave bujqësore, infrastrukturës rrugore dhe parandalimit të erozionit të brigjeve.

Drejtoria PPECK

Saimir Shehu